



REPUBLIKA E SHQIPEISE
PREFEKTI I QARKUT FIER

ANALIZA VJETORE 2025



17 Shkurt 2025



Prefekti.Fier@mb.gov.al



<http://prefektifier.gov.al/>

PËRMBAJTJA

RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER

FAQA 1

SEKTORI JURIDIK

FAQA 7

**KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIKIM / KRAT DHE KOMITETI RAJONAL PËR
PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË
DHUNSHËM**

FAQA 15

**SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE
TË DELEGUARA**

FAQA 16

SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES CIVILE

FAQA 23

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

FAQA 29

SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

FAQA 43

VEPRIMTARIA “PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”

FAQA 50

**OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026 PËR INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT
FIER**

FAQA 50

RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive gjatë vitit 2025, e përqëndroi veprimtarinë e vet, jo vetëm në forcimin e rritjes së rolit të Institucionit bazuar në ligjin për Prefektin e Qarkut, por edhe në forcimin dhe bashkëpunimin real me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policinë Vendore. Puna e Institucionit u përqëndruar në vijëmbësi të standartizimit, qasje reale të marrëdhënieve midis Institucionit të Prefektit të Qarkut në raport me Ministrinë dhe Institucionet e tjera Qendrore, me Degët Territoriale që veprojnë në qark dhe NJVQV, në drejtimet:

- Konsolidimi i pandërprerë i rolit të Prefektit në rritjen e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

- Forcimi i bashkëpunimit të punonjësve të Administratës shtetërore në çdo institucion apo degë territoriale dhe rritja e performancës në punë

Kjo duke u bazuar “

Ligji 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, ligj i cili ka përcaktuar rolin e prefektit si përfaqësues të Këshillit të Ministrave në qark, si garantues i zbatimit të programit të qeverisë në nivel qarku, përgjegjësitë dhe kompetencat e tij për realizimin e këtij misioni;

- Programi i Qeverisë 2021-2025 si dhe programin 2025-2029 të qeverisë Rama 4, program i cili në zbatimin e tij, kërkon impenjim, bashkëpunim, koordinim maksimal të këtij institucioni për zbatimin me sukses të reformave të miratuara, si dhe për arritjen e objektivave të vendosura nga qeveria Rama që synojnë përmirësimin e standartit të jetesës, të rrisë **të ardhurat për frymë**, të konsolidojë **financat publike**, të përmirësojë **pensionet dhe sigurimet shoqërore**, dhe të zhvillojë inovacionin dhe teknologjinë

Institucioni i Prefektit qarku Fier gjatë vitit 2025, ka ndjekur, monitoruar e shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, duke bashkërenduar punën, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka rritur kërkesat ndaj vetes dhe Institucioneve në fjalë duke intensifikuar punën dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me Njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të qarkut, nëpërmjet shkëmbimeve shkresore, takimeve me drejtues të institucioneve dhe drejtues të NJVV, ndjekjen e problematikave dhe jo vetëm, me qëllim krijimin e urave bashkëpunuese dhe ndërvepruese për zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2025, institucioni i Prefektit të qarkut, ka punuar në

- vijimin e standardizimit të mënyrës së hartimit të urdhrit, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtjen e dokumenteve shkresore, monitorimin e ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite

Rritjen e bashkëpunimit midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënien e qëllimshëm, kultivimi i lëndëve narkotike, etj.

Hartimin e Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

- intensifikimin e punës për bashkëpunimin real dhe konkret me strukturat përkatëse për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e

task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellët të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Të gjitha këto bazuar në objektivat e përcaktuara dhe miratuara nga ana e Prefektit për Institucionin tonë për vitin 2025 :-

❖ **Rritja e standardit të verifikimit të ligjshmerise se akteve te njesive te veteqeverisjes vendore, verifikimi i ligjshmerise i te cilave eshte ne kompetence te Prefektit.**

Veprime për zbatimin e objektivit:

- Verifikimi ligjor i akteve të NJVQV-ve në kompetencë të Prefektit, nga ana e sektorit juridik referuar kuadrit ligjor në fuqi. Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me sekretaret e keshillave bashkiak.
- Zbatimin me përgjegjësi të detyrës së verifikimit të ligjshmerise se akteve të NJVQV-ve nga sektori juridik. Ndjekja e shkalles hierarkike në përmbushjen e kësaj detyre. Dhenia e konsulences juridike sekretareve të keshillave, dërgim i shkresave sqaruese NJVQV-ve kur paraqitet nevoja.

❖ **Përmbushja me efikasitet dhe përgjegjësi ligjore e kompetences se Prefektit per sa i perket verifikimit ne vend te ligjshmerise se akteve me karakter normativ te NJVQV-ve.**

Veprime për zbatimin e objektivit:

- Zbatimi brenda afateve ligjore dhe me standard juridik i kontrollit periodik i verifikimit në vend të ligjshmerise se akteve normative të NJVQV-ve.
- Urdheri i prefektit në fillim të vitit 2025 për verifikimin në vend të ligjshmerise. Verifikimi në vend në muajt Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor 2025.
- Rritja e standardit ligjor të procedurës së verifikimit në vend të akteve me karakter normativ të NJVQV.

❖ **Mbrojtja e interesave ligjore të Institucionit.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
- Leshimi i autorizimit të prefektit për përfaqësim në gjykate nga sektori juridik. Hartimi i kërkesëpadisë, kundërpadisë, deklaratës së mbrojtjes, prapësimeve, ankimeve, ankimeve të veçanta, rekursit si dhe kryerja e çdo veprimi procedural të nevojshëm

❖ **Rritja e standartit ligjor të hartimit të shkresave nga administrata .**

Veprimet për zbatimin e objektivit”

- Përmirësimi i njohurive juridike gjatë përmbushjes së detyrave të administratës.

- Njohja ne kohe i administrates me ndryshimet ligjore.Hartimi i materialeve shpjeguese për administratën apo mbajtja e seminareve me tematika të caktuara me qëllim kualifikimin e administratës kur kjo kërkohet nga administrata apo titullari

-

- ❖ **Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i marrëdhënieve me Njësitë e Veteqeverisjes Vendore me qëllim njohjen dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre dhe evidentimin e problemeve për të cilat janë të interesuara NJVQV-të në raport me Organet e Qeverisjes Qëndrore.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Komunikim i vazhdueshëm me organet e NJVQV.Evidentimi i funksioneve dhe kompetencave të NJVQV.Ndjekja dhe monitorimi i ushtrimit nga ana e NJVQV të veprimtarisë së tyre lidhur me këto funksione dhe kompetenca.Dhënia e ndihmes proactive në formën e kërkuar, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre .
- Njohje më e mire nga ana e NJVQV-ve e funksioneve dhe kompetencave nga ana e tyre si dhe evidentim më i lartë i problematikave të NJVQV-ve kundrejt organeve të qeverisjes qëndrore

- ❖ **Zhvillimi i marrëdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministrinë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe strategjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar çdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Komunikim i vazhdueshëm me organet qendrore dhe vendore në forma të ndryshme për evidentimin e problematikave,• Në rast të kërkesave apo konflikteve institucionale midis qeverisjes qëndrore në nivel vendor dhe NJVQV-ve ndërhyr në realizimin e kërkesave apo zgjidhjen e konflikteve
- Në përfundim të veprimtarisë hartohet një raport mbi problematikën e ngritur i cili mund të shërbejë për unifikimin e marrëdhënieve në të gjitha Njësitë e Vetqeverisjes Vendore

- ❖ . Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve qëndrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të vecanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Parashikimi në plan pune i detyrave të sektorit përkatës. Zbatimi i afateve gjatë kryerjes së detyrave. Azhurnimi i vazhdueshëm me ndryshimet e reja ligjore.
- Realizimi me sukses i sezonit turistik veror dhe mbarëvajtja e veprimtarive të ndërmara nga Institucionet gjatë sezonit.

- ❖ . Ndjekja e veprimtarisë së organeve vendimmarrëse të NJVQV-ve, akteve normative të nxjerra prej tyre, nivelin juridik dhe funksional, nivelin e komunikimit me

publikun dhe transparencën. Koordinimi i punës ndërmjet Institucioneve rajonale për zhvillimin e konsultimeve me NJVQV-të për politikën, legjislacionin dhe normat që ndikojnë drejtëpërdrejtë në realizimin e funksioneve të NJVQV-ve.

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Prefekti i Qarkut do të kërkojë NJVQV ta vë në dijeni për gjithë procesin e hartimit të projektbudgetit vjetor dhe afatmesëm duke marrë pjesë në konsulta për realizimin e hartimit të tij, Institucioni i Prefektit të Qarkut do të kujdeset që procedurat kyçe të hartimit të projektbudgetit të kalojnë nga konsultat me publikun dhe grupet e interesit duke garantuar kështu transparencën e tyre dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit.

❖ Përdorimi dhe menaxhimi me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet i fondeve buxhetore nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Studimi i hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin pasardhës, duke bashkëpunuar me sektorët, në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- Bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike.
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

❖ Përmirësimi i kushteve të punës

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Përmirësimi i kushteve të punës, në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.
- Kompletimi i zyrave me orëditë të nevojshme.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme.
- Standardizimi i sistemit të dokumentacionit në zyrë dhe kujdesit për ambientin e punës.
- Zbatimi i kodit të etikës në punë,
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

❖ Arkivimi i dokumenteve

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
- Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave ankesave, kthim përgjigjeve etj.

- Zbatimi me rigorozitet i gjuhës shqipe dhe përmirësimit të mënyrës së formulimit të dokumentit.
- Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentacionit arkivor në vite.
- Përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit.

❖ **Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerezore**
Veprimet për realizimin e këtij projekti:

- Njohja dhe zbatimi i legjislacionit për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprorëve sipas shkallës së hierarkisë,
- (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Brendshme.
- *Administrimi i HRMIS*, hedhja e të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online.

❖ **Raportimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit Qarkut Fier**

Veprimet për realizimin e këtij projekti:

- VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”,
- Urdhëri i Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 11.4.2023 “Për zbatimin e VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.”

❖ **Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimi i detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban!**

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Zbatimi i Programit të Qeverisë 2021-2025 dhe 2025-2029
- Monitorimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për të gjashtë njësitë e vetqeverisjes vendore të Qarkut Fier!

❖ **Dhënie konsulencë dhe koordinim i punës me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore në qark, për çështje dhe problematika që hasin në procesin e planifikimit të territorit!**

Veprimet për realizimin e objektit:

- Përmirësimi i procesit të planifikimit për territorin e qarkut.
- Komunikimi periodik me njësitë e Vetqeverisjes vendore ose përgjigje ndaj kërkesave të tyre sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Koordinimi i punës dhe respektimi i hierarkisë institucionale me synimin e zhvillimit të territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

❖ **Nxitja e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimaterike dhe një zhvillim të qëndrueshëm**
Veprimet për realizimin e objektivit”

- nxitja e një zhvillimi të qëndrueshëm që do të rezistojë ndryshimeve klimaterike dhe një zhvillimi afatgjatë .
- Ndjekja e trainimeve dhe direktiva të qeverisë për t’ju ardhur në ndihmë njesive të vetqeverisjes vendore
- Ndjekja e direktivave të programit të qeverisë dhe botimet e Agjencisë së Mjedisit

❖ **Hartimi dhe miratimi i Planit për Emergjencat Civile, në nivel qarku**
Veprimet për realizimin e objektivit:

- **Sigurimi I** një reagim të shpejtë, efikas dhe të koordinuar për të menaxhuar pasojat e një situatë emergjente dhe rimëkëmbjen nga çdo ndikim negativ si pasojë e emergjencave apo fatkeqësive që mund të prekin jetën e njerzëve, gjëne e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore apo mjedisin në qarkun Fier:
- Bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me grupin e punës të përzgjedhur nga UNDP në kuadër të projektit RESEAL dhe strukturat vendore të Mbrojtjes Civile për hartimin e Planit për Emergjencat Civile, Qarku Fier.
- 2. Hartimi i Urdhërit të Prefektit për miratimin e planit.
- Dërgimi i planit për njohje strukturave vendore dhe qendrore të sistemit të Mbrojtjes Civile.

❖ **Sigurimi i funksionimit të sistemit të pralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku**

Do të mbështetet në :

Sigurimin i një informacion për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke iu mundësuar institucioneve dhe komunitetit të rrezikuar, marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e pasojave që mund të ndodhin si pasojë e një ngjarje emergjente të mundshme

Veprimet për realizimin e objektivit:

- Bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile që identifikojnë, mbledhin, përpunojnë, analizojnë, si dhe komunikojnë të dhënat që kanë të bëjnë me rreziqet e menjëhershme dhe ato të pritshme të cilat përbëjnë ose mund të kthehen në risqe për komunitetin.
- Njoftimi menjëherë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me dukuri të ngjarje, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të evidentuara ose të mundshme për t’u shfaqur në një periudhë kohe të shkurtër, të cilat përbëjnë ose mund të kthehen në risqe për komunitetin.

❖ **Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile**

Do të mbështetet në:

Rritja e ndërgjegjësimit të qytetareve në raport me mbrojtjen civile si dhe rritja profesionale brenda fushës së përgjegjësisë për nëpunësit e sektorit.

Veprimet për realizimin e objektivit:

- Organizimi i aktiviteteve në datat e shënuara që kanë lidhje me mbrojtjen civile, në bashkëpunim me strukturat vendore të MC. DAR apo edhe AKMC.
- Përgatitja e një materiali në poër-point dhe prezantimi i tij në ambiente publike, pranë njësive administrative apo institucioneve arsimore në qarkun Fier.
- Pjesëmarrja e nëpunësve në trajnime apo aktivitete të organizuara nga ASPA apo organizma të tjera, në fushën e mbrojtjes civile.

I. Objektivat kryesor të sektorit juridik për periudhën janar-dhjetor 2025.

- **Rritja e standardit të verifikimit të ligjshmerise së akteve te njësive të vetëqeverisjes vendore, verifikimi i ligjshmerise i të cilave është në kompetence te Prefektit.**
- **Përmbushja me efikasitet dhe pergjegjesi ligjore e kompetences se Prefektit per sa i perket verifikimit ne vend te ligjshmerise se akteve me karakter normativ te NJVQV-ve.**
- **Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.**
- **Rritja e standartit ligjor te hartimit te shkresave nga administrata .**

Në përmbushje të objektivave sektori juridik ka kryer këto detyra funksionale:

Verifikimin ligjor të akteve të NJVQV-ve në kompetencë të prefektit.

Në zbatim të nenit 8 shkronjat “a” dhe “j” dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 107/2016 “ Për Prefektin e Qarkut ” (i ndryshuar) sektori juridik ka kryer verifikimin e ligjshmërisë së akteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në Qarkun Fier që përfshihen në kompetencën e prefektit për tu verifikuar. Për periudhën janar-dhjetor 2025 nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në institucionin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe shqyrtuar për vlefshmëri ligjore 122 vendime të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Janë verifikuar dhe konfirmuar në përputhje me ligjin 112 vendime të këshillave. Janë kthyer si vendime në kundërshtim me ligjin 4 vendime konkretisht 1 vendim Këshillit Bashkiak Patos, 1 vendim Këshillit Bashkiak Roskovec dhe 2 vendime Këshillit Bashkiak

Divjakë. Të gjitha vendimet e kthyera nga prefekti janë marrë në rishqyrtim nga këshillat bashkiak përkatës.

Jashtë objektit të shqyrtimit nga prefekti kanë qenë 6 vendime 3 vendime të KB.Divjakë, 2 të KB.Lushnje dhe 1vendim I KB. Patos.

Për vitin 2025 nuk ka patur vendime të kundërshtuara në gjykatë për pavlefshmëri.

Vendimet e verifikuara kanë qenë me natyrë të ndryshme si miratimi i buxheteve dhe dokumentit përfundimtar të PBA-së, paktës fiskale, rishpërndarje fondesh në buxhet, miratimi i shtesave të fondit në buxhet, miratimi i kriterëve apo standarteve që lidhen me funksionet që i kanë kaluar këshillit, miratimi i tavaneve të shpenzimeve për PBA 2026-2028, i dokumentit të parë të PBA 2026-2028, dokumentit të rishikuar të PBA-së, përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, miratimi i planeve të ndryshme vendore etj.

Nga evidenca e akteve rezulton se për këtë periudhë bashkia me numrin më të madh të akteve të depozituara për verifikim ligjor është Bashkia Divjakë me 30 vendime ndërsa Këshilli i Qarkut rezulton me numrin më të vogël të vendimeve të depozituara, 7 vendime. Për vendimet e kthyera nga ana jonë është bërë argumentim ligjor. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe bazueshmërisë së tyre ligjore. Nga ana e tij sektori juridik kur i është kërkuar ka dhënë konsulencë juridike bashkive për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.

Pasqyra e akteve normative të NJVQV-ve në formë progresive për periudhën janar-dhjetor 2025 është si më poshtë:

NR		Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën janar-dhjetor 2024							
	Njësitë e vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti	Të bazuara në ligj	Të pa bazuara në ligj	Të rishqyrtuara	Verifikim i në vend i ligjshmërisë së akteve	Dërguar në gjykatë	Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	Akte jashtë objektit të shqyrtimit
		Prog	Prog	Prog	Prog	Prog	Prog	Prog	Prog
1	Këshilli i Qarkut Fier	7	7	0	0	5	0	0	0
2	Bashkia Fier	14	14	0	0	13	0	0	0
3	Bashkia Lushnje	20	18	0	0	19	0	0	2
4	Bashkia Mallakastër	11	11	0	0	10	0	0	0
5	Bashkia Divjakë	30	25	2	2	27	0	0	3
ë	Bashkia Patos	19	17	1	1	17	0	0	1
7	Bashkia Roskovec	21	20	1	1	19	0	0	0
TOTALI		122	112	4	4	110	0	0	6

Krahasuar me një vit më parë rezulton se :

Gjatë vitit 2025 nga ana e NJVQV-ve janë depozituar më pak akte për verifikim ligjor se gjatë vitit 2024.

Konkretisht: Për vitin 2025 janë depozituar gjithësej 122 vendime nga NJVQV-të ndërsa në vitin 2024 gjithësej 134 vendime.

Për vitin 2025 janë kthyer nga Prefekti i Qarkut si vendime në kundërshtim me ligjin 4 që është i njëjtë me numrin e vendimeve të kthyera për vitin 2024 pra 4 vendime.

Si gjatë 2025 edhe gjatë 2024 nuk ka patur vendime të kundërshtuara për pavlefshmëri në gjykatë.

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ

Sektori juridik në zbatim të nenit 17 të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, (i ndryshuar), Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21 datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr. 39, datë 20.02.2025, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut si dhe aneksin 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut” ka kryer verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ për periudhat dhjetor 2024, janar-shkurt 2025; mars – maj 2025; qershor-gusht 2025; shtator-nëntor 2025.

Verifikimi në vend është parashikuar për tu kryer në planin vjetor dhe planin mujor përkatës.

Verifikimi është kryer çdo tre muaj si kërkesë e ligjit.

Objekt i verifikimit ka qenë:

- Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të miratuara nga këshilli bashkiak/këshilli i qarkut si dhe i akteve me karakter normativ të kryetarit të bashkisë, për periudhën objekt kontrolli.
- Vendimet e këshillit të kthyera nga Prefekti i Qarkut si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt kontrolli.

Grupi i punës ka mbajtur për cdo verifikim procesverbalin në vend si dhe ka dërguar tek cdo bashki dhe në këshillin e qarkut raportin përfundimtar mbi verifikimin e ushtruar. Grupi i punës gjatë verifikimit në vend ka dokumentuar edhe ecurinë e vendimeve të kthyera nga prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt kontrolli. Rezulton se vendimet e kthyera si vendime në kundërshtim me ligjin, këshillat bashkiak respektiv i kanë marrë në rishqyrtim në mbledhjen pasardhëse.

- ❖ **Gjatë verifikimit në vend nuk janë gjetur akte me karakter normativ të padepozituara nga NJVQV-të për verifikim ligjor.**

➤ **Për sa i përket proceseve gjyqësore.**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kemi patur 1 proces gjyqësor në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Lushnje me palë :

Përfaqësimi në gjykatë në ceshtjen gjyqësore me palë : Padites i Paditur: Prefekti i Qarkut Fier, DAP-i sipas objektit të kerkese padise.

PADITËSE: Syri Malaj

I PADITUR: Prefekti i Qarkut Fier

ME OBJEKT: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit Nr. 1387/13 Prot. Datë 13.04.2016 të Departamentit të Administratës Publike.

Detyrimin e palës së paditur Prefekti i Qarkut Fier për të paguar diferencën e pagës të krijuar për shkak të ndryshimit të pozicionit nga përgjegjës zyre kategoria IV-a në specialist kategoria IV-c për periudhën 01.01.2016 deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Prefekti i Qarkut Fier është përfaqësuar në gjykim nga P.Feneri specialist i sektorit juridik. Nga ana jonë kemi paraqitur parashtrimet tona me shkrim çështja është ende në shqyrtim gjyqësor nga kjo gjykatë.

Për sa i përket detyrave të tjera:

- Sektori juridik ka raportuar tek prefekti i Qarkut dhe Sekretari i Përgjithshëm mbi veprimtarinë e zyrave të arkivit të gjendjes civile (funksion i deleguar) çdo muaj.

Për periudhën janar-dhjetor 2025 zyra e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut ka ushtruar veprimtarinë si më poshtë vijon:

- 1- Ka zbatuar me përpikmëri metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile.
- 2- Ka treguar kujdes i veçantë në mirëmbajtjen e regjistrave themeltar dhe të akteve të lindjeve, martesave, dhe vdekjeve të Zyrës së Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier pasi ambjeti ku janë në ruajtje është në kushte shumë të këqija;
- 3- Ka kontrolluar veprimtarinë e punës në Zyrat e Gjendjes Civile të Njësisve Administrative pranë Bashkive të Prefekturës së Qarkut Fier;
- 4- Është shkëmbyer në mënyrë të rregullt korrespondenca me institucionet shtetërore dhe personat juridikë privatë;

- 5- Janë ndjekur poceset gjyqësore në mënyrë të rregullt;
- 6- Është ndjekur ecuria për mbarëvatjen e procesit zgjedhor në printim dhe publikim të listave zgjedhore.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë ofruar shërbime online nga NCR dhe SQDNE si vijon:

- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier 19667 shërbime;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Mallakastër 2852 shërbime;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Lushnje 7900 shërbime.
- Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21 datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut” nga ana e sektorit juridik është bërë azhurnimi në kohë i administratës me ndryshimet ligjore dhe kemi ofruar konsulencë ligjore sektorëve në përmbushje të detyrave të tyre.
- Sektori juridik ka zbatuar rekomandimet e lëna në vitin 2024 nga KLSH. Plotësimi i tyre është i evidentuar edhe në planin e veprimit mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH të hartuar nga sekretari i përgjithshëm.

Përveç kryerjes së detyrave të mësipërme sektori juridik ka përmbushur edhe një sërë detyrash të tjera si vijon :

- Specialisti i sektorit juridik z. Pëllumb Feneri ka ushtruar detyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, duke përmbushur detyrat e ngarkuara nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe mbrojtjen e të dhënave personale duke ndjekur me përparësi çdo kërkesë të ardhur nga qytetarët për informacion si dhe ka ndjekur përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve në kuadrin e ligjit për të drejtën e informimit.
- Specialisti Z.Albion Arizi ka ushtruar detyrën e anëtarit të komisionit për shqyrtimin e sanksionit plotësues për lejedrejtimin të leshurara nga një shtet i huaja si dhe ka raportuar veprimtarinë e zyrave të arkivit të gjendjes civile.
- Specialist A. Arizi ka marrë pjesë si anëtar i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël në institucion për vitin 2025.
- Përgjegjësjë e sektorit juridik ka ndjekur dhe kontrolluar punën e sektorit për sa i përket verifikimit të ligjshmërisë së akteve të NJVQV-ve, ka marrë pjesë në verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve në të gjitha NJVQV-të, ka përgatitur evidencën mbi verifikimin e akteve normative çdo muaj, planet mujore të punës, vlerësimin e specialistëve për veprimtarinë e punës të kryer për vitin 2025. Përgjegjësjë e sektorit në bashkëpunim me

sektorin e kompetencave vendore dhe sektorin e mbrojtjes civile ka dërguar cdo të enjte informacion në Ministrinë e Brendshme mbi veprimtaritë më të spikatura në Qarkun Fier.

- Sektori juridik ka përmbushur të gjitha detyrat që janë ngarkuar nga Prefekti apo Sekretari i Përgjithshëm në zbatim të urdhërit Nr. 21 datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”
- Për periudhën janar-dhjetor 2025 nuk ka detyra të perealizuara apo të pregatitura në tejkalim të afateve ligjore.

2-Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i marrëdhënieve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim njohjen dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre dhe evidentimin e problemeve për të cilat janë të interesuara NJVQV-të në raport me Organet e Qeverisjes Qëndrore.

Ky objektiv u realizua nëpërmjet:

- Ofrimit të ndihmës dhe asistencës në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Institucionit të Prefektit, organeve të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore për realizimin e kompetencave, funksioneve të tyre me qëllim shtrirjen dhe zbatimin e programit qeverisës në nivel vendor, zbatimin e strategjive kombëtare dhe rajonale të miratuara, përmbushjen e parimit të decentralizimit si një proces i cili synon të përmirësojë efektivitetin e administratës publike dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.
- Realizimit të takimeve, pjesëmarrja në aktivitete,
- Përgatitjes së raporteve lidhur me tema të caktuara që i përkasin kompetencave të NJVQV-ve.
- Dhënies së ndihmës proactive në formën e kërkuar, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre .

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit ka si mision përmbushjen e detyrimeve të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” I ndryshuar nenin nr.15 që përcakton :

*1.Ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie.
2. Marrëdhëniet ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.*

Konkretisht :

- Është realizuar komunikimi me Institucionet shtetërore dhe NJVQV-të për çështje specifike sipas rastit në varësi të korrespondencave të caktuara

- Është kërkuar informacion lidhur me planin e të ardhurave sipas kategorive të taksave
- Është kërkuar informacion lidhur me aktivitetet dhe evenimentet
- Është kërkuar depozitimi pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut të kopjeve të :
 - ✚ planit të zhvillimit
 - ✚ projektbuxhetit vjetor
 - ✚ strukturës
 - ✚ organikës
- Është realizuar takimi me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore më datë 21.08.2025 lidhur me:
 - ✚ Informimin mbi situatën aktuale të regjistrimit të ashensorëve;
 - ✚ Identifikimin e hallkave problematike në zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë e ashensorëve;
 - ✚ Përcaktimin e rolit dhe angazhimi i institucioneve vendore në këtë proces.
- Ndjekja e aktiviteteve për dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Takimet :
 - Më datë 04.03.2025 pjesëmarrje në takimin e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
 - Më datë 27.08.2025 pjesëmarrje në takimin e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
 - Më datë 23.09.2025 pjesëmarrje në takimin e organizuar pranë Qendrës Sociale Komunitare Roskovec për rastin e një të miture.
 - **Në total 3 takime të GNT-së.**

- **Takimet e Komitetit Rajonal Antitrafikim / KRAT-it u realizuan në datat :**

- 27.02.2025
- 17.06.2025
- 25.09.2025
- 18.12.2025

Janë dërguar infomacionet Koordinatorit Kombëtar.

- **Takimet e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**

- 20.02.2025
- 26.06.2025
- 30.09.2025

Janë dërguar informacionet Koordinatorit për Ekstremizmin e dhunshëm



- ❖ **Zhvillimi i marrdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministrinë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe startegjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar cdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.**

Ky objektiv u realizua nëpërmjet:

- krijimit të mundësive për një bashkëpunim më të mirë dhe më të frytshëm ndërmjet Institucioneve në nivel horizontal dhe vertikal në mënyrë që problematikat të zgjidheshin dhe të mos krijohen mbivendosje kompetencash, mosmbulim të funksioneve të sipërpërmendura apo moskoordinim të tyre
- Kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së Degëve Territoriale në Qark.
- Hartimit të raporteve të monitorimit të Degëve Territoriale në Qark

Konkretisht :

- Analizimi i veprimtarisë vjetore 2024 të Degëve Territoriale dhe adresimi i problematikave të konstatuara Ministrive përkatëse.
- Është kërkuar dhe përpunuar informacion mujor për veprimtarinë e Degëve Territoriale në Qark dhe janë ndjekur evidencat e dërguara nga degët territoriale.
- Janë hartuar materialet informative Ministrisë së Brendshme
- Kemi ndjekur Paketën e Sigurisë në shkolla.

Prefekti i Qarkut me urdhërin Nr. 47 datë 01.09.2025 ngriti një grup pune për të kryer monitorimin në disa nga shkollat e qarkut Fier lidhur me 4 elementë:

- a. Marrjen e masave për përgatitjen e ambienteve të mësimdhënies dhe kushteve higjieno-sanitare
- b. Vendosjen e sinjalistikës së plotë rrugore, vertikale dhe horizontale pranë çdo institucioni të arsimit parauniversitar, privat dhe publik.
- c. Vendosjen e kamerave të sigurisë në të gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla.
- d. Vendosjen e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjëse për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla

Rezultate

Nga grupi i punës në terren janë monitoruar **26 shkolla** në Qarkun Fier , në të cilat janë evidentuar këto mangësi dhe problematika, të ndara si më poshtë vijon sipas bashkive përkatëse ;

Bashkia Patos

1. Në shkollën “ **Meleq Gosnishti**” , Bashkia Patos dyert e tualeteve të katit të parë, janë të pajisura me xham transparent, ndërsa duhej të jenë të veshura me një material tjetër që pengon pamjen. Tualeti i katit të dytë kishte rrjedhje nga tubacioni i ujit që shkakton lagështi në palestrën e shkollës.
2. Në shkollën “**Hekuran Maneku**”, Bashkia Patos, u konstatua lagështirë në tualetet si pasojë e tubacioneve të vjetra e të amortizuara që duhen zëvendësuar me të reja.
3. Në shkollën “**Sotir Çapo**” Njësia Zharrëz, Bashkia Patos u konstatua mungesa e kushteve higjieno-sanitare në tualete si dhe lagështirë në muret e tyre.

Bashkia Roskovec

4. Në shkollën “**Rexhep Kothere**” Njësia Kuman, Bashkia Roskovec gjendja e tualeteve ishte e papërshtatshme ,me dritare pa xhama dhe dyer të amortizuara.

5. Në shkollën **”Adem Vrapit”**, Bashkia Roskovec, mungonin pajisjet për shuarjen e zjarrit dhe shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla. Me gjithë kërkesat e bëra nga drejtuesit e shkollës për vendosjen e tyre akoma mungojnë.
6. Në shkollën **”Alush Greçka”**, Bashkia Roskovec, nuk ishin instaluar kamerat e sigurisë në perimetrin e sigurisë për shkollat. Rrezik përbënte edhe muri rrethues i shkollës në fjalë, në një pjesë të segmentit të tij, në të majtë duke filluar nga hyrja kryesore, rrezikonte seriozisht jetën e nxënësve, pasi ishte në lartësi të pamjaftueshme sigurie.

Bashkia Lushnje

7. Në shkollën **”Foto Puka”**, Bashkia Lushnje, u konstatua mungesa e kamerave të sigurisë, ndërsa fasada dhe ambientet e jashtme ,ndihmëse kanë nevojë për ndërhyrje për tu rikonstruktuar e rifreskuar (fasada, muret e tj)
8. Në shkollën **”Kongresi i Lushnjes”**, Bashkia Lushnje, nuk janë vendosur kamerat e sigurisë.
9. Në shkollën **”Skënder Libohova”**, Bashkia Lushnje, gjithashtu mungojnë kamerat e sigurisë.
10. E njëjta situatë edhe në shkollën **”18 Tetori”** kamerat e sigurisë nuk janë instaluar.
11. Në shkollën **”Vath Koreshi”**, Bashkia Lushnje kamerat e instaluar janë jashtë funksionit sepse nuk kanë bateri dhe hard disku është djegur. Gjithashtu fasada e shkollës ka nevojë për lyerje, rifreskim të pamjes së saj.

Bashkia Divjakë

12. Në shkollën e mesme të bashkuar **”Çermë-Shkumbin”**, Bashkia Divjakë, kamerat e sigurisë nuk janë instaluar.
13. Në shkollën **”Koli Sako”**, Bashkia Divjakë, kamerat e sigurisë nuk janë instaluar, mungojnë pajisjet për shuarjen e zjarrit, tualetet kanë lagështi dhe myk.
14. Në shkollën **”Miti Zoi Zaka”**, Bashkia Divjakë, kamerat e sigurisë megjithëse janë instaluar janë jashtë funksionit për shkak se mungon ‘njësia qendrore’ e sistemit monitorues, gjithashtu mungojnë edhe pajisjet për shuarjen e zjarrit.
15. Në shkollën **”Shën e Premte”**, Bashkia Divjakë mungon sistemi i kamerave të sigurisë, tualetet megjithëse janë të pastra e funksionale është e nevojshme ndërhyrja në kanalizimin dhe në pusëtën për eliminimin e erës së keqe që ndihej e fortë pothuaj çdo ditë sa hapen dyert e shkollës.

Bashkia Fier

16. Në shkollën **”Janaq Kilica”**, Bashkia Fier, kamerat e sigurisë megjithëse janë instaluar janë jashtë funksionit për shkak se “hard disku “është djegur dhe nuk regjistron , si dhe ka mungesë të sinjalistikës horizontale.
17. Në shkollën **”Naim Frashëri”** Bashkia Fier, u konstatua mungesa e sinjalistikës horizontale dhe verikale.
18. Në shkollën jopublike **”Alen”** Bashkia Fier, u konstatua mungesa e mjeteve për shuarjen e zjarrit.

Bashkia Mallakastër

19. Në shkollën “5 *Shkurti*” Bashkia Mallakastër u konstatua mungesa e kamerave të sigurisë.

20. Në shkollën “ *Ismail Klosi*” Bashkia Mallakastër ka nevojë për ndërhyrje në fasadë, lyerja e brendshme dhe e jashtme nuk është bërë, kushtet higjeno-sanitare nuk janë të përshtatshme për një ambient shkollor.

- Është hartuar dhe dërguar përmbledhja e veprimtarisë pranë Ministrisë së Brendshme
- Është kërkuar informacion DRAP dhe ZVAP lidhur me maturën shtetërore
- Është kërkuar informacion DRAP dhe ZVAP lidhur me Provimet Kombëtare të Arsimit bazë

❖ **Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qëndrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2025, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të vecanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjenës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.**

- Është realizuar koordinimi dhe është ofruar bashkëpunimi nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut me NJVQV për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik dhe për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.
- Takimi i Task – Forcës së Turizmit u zhvillua më datë 22.05.2025
- Shkresë bashkive për procesin e lidhjes së kontratave
- Shkresë bashkive për :

✚ Procesin e përgatitjes së hartave të përgjithshme të stacioneve të plazhit përgjatë vijës bregdetare Zonat e cadrave

✚ Vendndodhjen e kullave të vrojtimit

✚ Zonën e shërbimeve në hapësirën e plazhit

✚ Hapësirat ujore të lejuara

✚ Vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre

✚ Zonat rekreative etj

- Urdhri për ngritjen e task-forcës për sezonin turistik 2025 Nr.34 datë 22.05.2025
- Është dërguar urdhri për ngritjen e task- forcës gjithë institucioneve përgjegjëse
- Hartimi i planit të masave në nivel vendor/ dërguar Ministrisë së Brendshme
- Me qëllim monitorimin e zbatimit të planit të masave, sipas Urdhërit të Kryeministrit për sezonin turistik veror 2025, Prefekti i Qarkut Fier, nxori Urdhër Nr.39, Datë 26.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e planit të masave në terren për sezonin turistik veror 2025 në territorin e Bashkisë Fier” dhe Urdhër Nr.41, Datë 01.07.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e planit të masave në terren për sezonin turistik veror 2025 në territorin e Bashkisë Divjakë”.

Nga monitorimi i grupit të punës në terren, janë evidentuar mangësi në stacionet e plazhit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre :

1. U evidentuan 5 (pesë) subjekte pa kontratë me Agjensinë Kombëtare të Bregdetit (AKB)

- U la detyrë në vend Bashkisë Fier, Strukturave të Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së shtetit marrjen e masave që parashikon ligji për këto raste.
2. U evidentuan në disa stacione plazhi një numër më i madh çadrash se ai i përcaktuar në VKM
U la detyrë Agjensisë Kombëtare të Bregdetit dhe Policisë Bashkiake marrjen e masave sipas VKM-së
 3. Mungesa në disa stacione të vrojtuesit të plazhit, përgjatë gjithë kohës që subjekti ushtron veprimtarinë e tij.
U la detyrë AKB-së dhe ju kërkua subjekteve marrja e masave për vendosjen e vrojtuesve të licensuar, sipas ligjit.
 4. Mungesa e tabelave informuese në disa stacione për numrat e telefonit të ambulancës, policisë, zjarrfikses.
U la detyrë dhe ju kërkua subjekteve vendosja sipas kërkesave të ligjit e tabelave në vende të dukshme.
 5. Mungesa e sinjalistikës në det dhe kufizimit me bova. Shumica e subjekteve u justifikuan se për shkak të rrymës, deti i nxjerr në breg.
U la detyrë AKB-së dhe ju kërkua subjekteve gjetja e mënyrave dhe mjeteve të përshtatshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre në distancat dhe standartet kërkuara nga ligji.
 6. Vendosjen e flamujve sinjalizues me shkop 3.5m të lartë.
U la detyrë AKB-së dhe u kërkua vendosja e flamujve në lartësinë e duhur.
 7. Shkarkim i ujërave të përdorura u konstatua mungesa e kontratave midis subjekteve dhe firmav të licensuara.
U la detyrë Bashkisë Fier, rregullimi e kësaj çështjeje si dhe u është bërë vërejtje subjekteve dhe u kërkua prej tyre të lidhin kontratat përkatëse për përpunimin, heqjen e ujërave të përdorura.

Në subjektet që janë evidentuar disa problematika, grupi i inspektimit në terren kërkoi plotësimin e mangësive, zbatimin e kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit. Gjithashtu grupi i punës ka konstatuar në shumë raste mungesën e sinjalistikës që evidentojnë zonën e caktuar si plazhit publik, shenjat treguese të largësisë së lejuar për notim dhe për zonat që janë të rrezikshme për pushuesit. Firma e pastrimit e kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Bashkia Fier ka vijuar punën e pastrimit në terren, në zbatim të kushteve të kontratës. Për shërbimin mjekësor, Qendra Shëndetësore në Darzezë vijon punën normalisht 24 orë. Ndërsa në zonën e Semanit nuk ka një qendër shëndetësore. Për zonën e Bashkisë Divjakë, sipas kontrollit të grupit të punës në terren, stacionet e plazhit i plotësojnë të gjitha kushtet e VKM ,Nr. 649 ,Dt. 16.10 2024.

- Raportimi në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e task – forcës për sezonin turistik veror.
- Nga 1 janari deri në 31 Dhjetor 2025 parku arkeologjik i Apolonisë ka patur **127000** vizitorë, nga të cilët të huaj **80500** të huaj.
- Për Parkun Arkeologjik Bylis, nga 1 janari deri në Dhjetor 2025, kemi **10726** vizitorë.
Të huaj 3814

- Është krijuar database për emrat e kontaktit të task-forcës për sezonin turistik
- Janë trajtuar gjithë kërkesat për bashkëpunim kundrejt institucioneve lidhur me turizmin
- Dërguar raporti përfundimtar në Ministrinë e Brendshme dhe Kryeministri.

❖ **Realizuar 1 takim:**

- 22.05.2024 – Takimi i I Task – Forca





Detyra të tjera:

- Është mbledhur informacioni nga NJVKSH dhe është kryer raportim javor në ZOS për cdo situatë të krijuar
- Janë hartuar dhe plotësuar database për vdekshmërinë foshnjore dhe cilësinë e ujit të pijshëm
- Cdo ditë është bërë legalizimi i dokumentacionit për jashtë vendit. Për ndryshimet në drejtuesit e NjVQV-ve, Njësive administrative, apo punonjësit e gjendjes civile është mbajtur korespondencë dhe komunikim i vazhdueshëm. Në total janë legalizuar **1659** certifikata.(Në bashkëpunim me sektorin e mbështetjes)
- Dy punonjës janë të ngarkuar dhe ushtrojnë detyrat e Sekretariatit teknik të KRAT duke zbatuar gjithë legjislacionin përkatës, duke mbledhur informacionet dhe organizuar takimet.
- Dy punonjës janë të ngarkuar dhe ushtrojnë detyrat e Sekretariatit teknik të Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm duke zbatuar gjithë legjislacionin përkatës, duke mbledhur informacionet dhe organizuar takimet.
- 1 punonjës është i ngarkuar dhe ushtron detyrat e Sekretariatit Teknik për Këshillin Konsultativ Trepalësh

Ky Këshill përfaqëson një mekanizëm të ri të rëndësishëm të dialogut social, të ngritur në zbatim të VKM nr. 551, datë 04.09.2024 “ Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në këshillin konsultativ trepalësh rajonal” me urdhërin Nr. 35 datë 19.05.2025 “ Për ngritjen e Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal të Qarkut Fier”.



- Janë administruar shkresat e ardhura dhe është kryer korespondenca e nevojshme. Në total **80** shkresa .(letërnjoftime me institucionet).
- Jane administruar **75** kërkesë ankesa të qytetarëve lidhur me Institucionet. Ndjekja e problematikave në lidhje me ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve/ Kthim përgjigje -65 / Pa përgjigje -10.
- Azhornimet në faqen ËEB të Institucionit të Prefektit.
- Është hartuar dhe dorëzuar tek Sekretari I Përgjithshëm
 - Analiza vjetore 2025
 - Rregullore
 - Regjistri i Riskut
 - Plan Vjetor 2025
 - Objektivat 2025
 - Planet mujore
 - Vlerësimet
 - Listëprezencat mujore
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Bashkinë Roskovec më datë 27.01.2025 lidhur me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga qendra Epoka e Re më datë 04.02.2025 lidhur me prezantimin e rezultateve të arritura gjatë implementimit të projekteve.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Hotel Fieri më datë 20.02.2025 me temë “ Ndihmë rast pas rasti”, në kuadër të javës ndërgjegjësuere për mbrojtjen e viktimave të krimit.
- Më datë 07.03.2025 Prefekti i Qarkut në bashkëpunim me DRAP organizuan takimin me temë “ *Vlerësim dhe mirënjohje për mësuesit*”.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Bashkinë Roskovec më datë 11.04.2025 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve.

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Bashkinë Roskovec më datë 17.04.2025 me temë “ *Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse në zbatim të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje*”.
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar në qytetin e Vlorës nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) më datë 28.04.2025 me temë “ *Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla aktivitetin I dhe II, vlerësimi I derdhjes, si dhe impakti I ndotjes në shëndet publik*”.
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 15.07.2025 për project planin e mbështetjes sociale 2025-2026.
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 16.07.2025 për project planin e mbarështimit të pyjeve në zonën Seman 2.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Bashkinë Divjakë më datë 17.07.2025 lidhur me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 05.08.2025 për planin e arsimit parauniversitar 2025-2027
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 05.08.2025 për barazinë gjinore 2025-2027
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 09.09.2025 me temë “ *Konsultimi i ndryshimeve të paketës fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA 2026-2028 dhe Buxhetit për vitin 2026*”
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në qendrën “ Epoka e Re” me temë “ *Shëndet për Barazi dhe Siguri- Forcimi i reagimit ndërinstitucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Fier*”.
- Pjesëmarrja në datën 14.11.2025, në bibliotekën "Dritëro Agolli", kati 4 në aktivitetin "Ngjyrat e respektit", antitrafikim.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, nën moton “Për t’i Dhënë Fund Dhunës Digjitale ndaj Grave dhe Vajzave më datë 25.11.2025, me organizimin e një marshimi sensibilizues.
- Pjesëmarrje në dëgjesën publike në Bashkinë Patos më datë 25.11.2025 për prezantimin e buxhetit përfundimtar në Bashkinë Patos 2026-2028.
- Pjesëmarrje në takimin në qendrën Epoka e Re më datë 26.11.2025 për sigurinë publike.
- **Totali i takimeve pjesëmarrëse me tematika të ndryshme - 23**
- Kthim përgjigje Brenda afateve për gjithë emalet e ardhur
- Pritja dhe dhënia e informacionit për çdo qytetar që është paraqitur pranë Insitucionit.

3-Nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile gjatë vitit është punuar edhe për përmbushjen e objektivave vjetore sektoriale, të përcaktuara që në fillim të vitit 2025:

Vëmendja kryesore në fushën e mbrojtjes civile ka qenë evidentimi dhe ndjekja e masave parandaluese për emergjencat civile në nivel qarku dhe ndjekja e ritmikës së realizimit të tyre, si

dhe angazhimi i struktuarve operationale nëpërmjet koordinimit të Prefektit në rastet e situatave emergjente të krijuara, kryesisht gjatë periudhës së dimrit dhe verës.

Nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile gjatë vitit është punuar edhe për përmbushjen e objektivave vjetore sektoriale, të përcaktuara që në fillim të vitit 2025 si:

- Hartimi dhe miratimi i Planit të Emergjencave Civile në nivel qarku.
- Sigurimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku.
- Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti i padiskutueshëm i vijimit të rolit dhe vëmëndjes së treguar nga Qeveria Shqiptare dhe strukturave qendrore në fushën e mbrojtjes civile, nëpërmjet:

- Thirrjes për aplikim për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive”
- “Fondit për Digat”
- Transfertes për përdorim të fondit, nga buxheti i shtetit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, për 6 (gjashtë) bashkitë e qarkut Fier

❖ **Drejtimi i punës së bërë për emergjencat civile**

Nga sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile është punuar për:

Zbatimin dhe përmbushjen e detyrave të përcaktuara në gërmën “dh” të nenit 8 dhe nenit 13 të ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 27, neni 28, neni 29, pika 2, gërma b) e nenit 50, neni 65 të ligjit Nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, akteve ligjore e nënligjore në funksion të zbatimit të tyre, si dhe objektivave institucionale, si më poshtë:

❖ **Objektivat e Sektorit**

Objektivi Nr. 1

Hartimi dhe miratimi i Planit të Emergjencave Civile në nivel qarku

Objektivi është realizuar.

Për realizimin e objektivit, Prefekti me urdhër, ka ngritur grupin e punës për koordinimin, plotësimin dhe shkëmbimin e informacionit të të dhënave me ekspertët e përzgjedhur nga AKMC për hartimin e Planit të Emergjencave Civile, në kuadër të projektit REASEAL, të financuar nga UNDP.

Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, Institucioni i Prefektit, nëpërmjet Sektorit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile, ka koordinuar punën midis ekspertëve dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për hartimin e dokumentit të Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut dhe Planet Vendore për Emergjencat Civile, për gjashtë bashkitë e qarkut Fier.

Pas përfundimit të hartimit të dokumentit të Planit për Emergjencat Civile në nivel qarku, nga ana e ekspertëve kombëtar, Prefekti i Qarkut me urdhërin Nr. 36, datë 22.05.2025. ka miratuar Planin për Emergjencat Civile të Qarkut Fier.

Objektivi Nr. 2

Sigurimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku

Realizuar.

Rritja e bashkëpunimit me strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile për identifikimin, mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rreziqet e menjëhershme dhe ato të pritshme, është një objektivi që është realizuar çdo ditë dhe rast pas rasti.

Për realizimin e këtij objektivi nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile janë mbajtur kontakte të përditshme me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Strukturat Vendore të sistemit të mbrojtjes civile, duke përcjellë çdo ditë të dhëna që vinë nga IGJEO apo SHMU.

Nga strukturat e Mbrojtjes Civile ka funksionuar zinxhiri i paralajmërimit të hershëm, si për situatat e zjarreve dhe për përmbtyjet. Janë mbajtur kontakte dhe bashkëpunim i ngushtë me mediat lokale, me qëllim informimin dhe paralajmërimi të komuniteteve të rrezikura.

Objektivi Nr. 3

❖ Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile.

Realizuar.

Objektivi është realizuar nëpërmjet organizmit të takimeve të përbashkëta dhe gjithëpërfshirëse, ku vlen të theksohen aktivitetet e organazuara nga AKMC apo edhe struktura të tjera në nivel vendor dhe qendror, me pjesëmarrje të strukturave qendrore dhe vendore të M. Civile ku janë trajtuar tematika si:

- “Programi për një Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri” organizuar më datë 20.02.2025, në kuadër të projektit ALBAdapt.
- “Përdorimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”, organizuar më datë 17.04.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC).
- “Takim sensibilizues me Administratorët, Kryetarët e fshatrave dhe përfaqësues të Komisarariatit të Policisë Divjakë” organizuar më datë 28.07.2025, në lidhje me


informacionin në kohë reale, bashkëpunimin dhe angazhimin në rastet e situatave të zjarreve.

- Aktivitet informues dhe sensibilizues me komunitetin “Mbi njohjen e riskut mbi situatat emergjente, mënyrë e reagimit dhe bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse.
- Trajnim në nivel rajonal “Mbi rritjen e kapaciteteve të sistemit të përgatitjes dhe reagimit ndaj ndotjeve detare në Shqipëri”, organizuar më datë 21-23 Tetor 2025, nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.
- Trajnim “ Mbi vlerësimin e dëmtimeve dhe përdorshmërisë së ndërtesave pas tërmetit” organizuar nga Instituti i Ndërtimit dhe AKMC.
- Ëorkshop-it të organizuar më datë 10.13 Dhejtor 2025, në Rakitje, Kroaci, mbi “Sistemet e Komandës së Incidenteve në Evropën Juglindore – Mjetet dhe Procedurat për Ndërveprimin e Shërbimeve të Emergjencës”
- Takimeve të organizuar nga Komisioni i Mbrojtjes Civile, Qarku Fier, etj.

❖ Detyra të tjera të realizuara:

- Përditësimi i dosjes me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e Mbrojtjes Civile.
- Rifreskimi i planit të masave për sezonin vjeshtë - dimër dhe pranverë - verë 2025.
- Përditësimi i bazës së të dhënave mbi situatat e zjarreve në nivel qarku.
- Pjesëmarrje dhe përfaqësim i institucionit në takime dhe aktivite në fushën e mbrojtjes civile.
- Ndjekje dhe zbatim i detyrave që rrjedhin nga urdhrat e brendshëm të institucionit
- Hartimi dhe konceptimi i shkresave, informacioneve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore.
- Monitorimi në terren i hidrovoreve, digave dhe argjinaturave lumore, apo edhe situatave konkrete në rastet e zjarreve dhe përmbytjeve, etj.

❖ Emergjencat e ndodhura nga zjarret



Gjatë vitit 2025, nga raportimet e strukturave vendore të mbrojtjes civile dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, janë evidentuar 178 raste zjarri nga të cilat: 27 raste në objekte, 11 raste në ekonomi pyjore, 38 raste në ullishte, 82 raste në shkurre dhe ferra, 13 raste në depozita bari, 7 raste në automjete.

SHPËRNDARJA E RASTEVE TË ZJARREVE

Emërtimi NJ.V.Q.V	Raste Gjiths ej	Objekte		Sipërfaqet e veshura me bimësi						Depo zita bari për blekt orinë	Automjete
		Rastet	Private	Rastet	Pyje		Ullishte		Sip. djerrë (Rastet)		
					Rastet	Sipërf . e Djegu r (në ha)	Rastet	Sasia e Djegur (në rrënjë)			
Qarku Fier	178	27	27	131	11	248.7	38	3297	82	13	7
Bashkia Fier	47	11	11	33	3	23.8	9	1145	21	3	0
Bashkia Lushnje	25	6	6	13	0	0	7	640	6	2	4
Bashkia Mallakast ër	18	1	1	17	6	224	6	423	5	0	0
Bashkia Patos	38	4	4	34	0	0	10	670	24	0	0
Bashkia Roskovec	33	3	3	25	0	0	3	244	22	4	1
Bashkia Divjakë	17	2	2	9	2	0.9	3	175	4	4	2

Konstatime:

- Në raport me vitin 2024, gjatë vitit 2025 ka një tendencë në ulje të numrit të përgjithshëm të rasteve të zjarreve, kryesisht në territorin e bashkisë Lushnje e më konkretisht në sipërfaqet me hamullore dhe shkurre.
- Repartet e MZSH-ve, gjatë veprimtaisë së tyre reaguese, edhe pse është bërë shumë punë, përsëri kanë mangësi, si në sasi ashtu dhe në cilësi të kapaciteteve teknike e logjistike të tyre.
- Mungojnë investime në infrastrukturën rrugore për zonat malore apo kodrinore të veshura me ekonomi pyjore, ullishte apo bimësi të egër duke vështirësuar edhe më shumë punën e shërbimit zjarrfikës.

- Në zonat urbane në afërsi të zonave me risk të lartë zjarri, mungonë rrjeti i hidrantëve për furnizimin me ujë të mjeteve zjarrëfikse

❖ **Emergjencat dimërore**

Gjatë vitit 2025, në territorin e Qarkut Fier gjatë sezonit dimëror, Nëntor 2025 ka pasur disa problematike të shkatura nga reshjet, kryesisht problematika me përmbytje të tokave bujqësore që shtrihen brenda argjinaturave, përgjatë rrjedhës së lumenjve Vjos, Seman dhe Shkumbin dhe prezencë e ujërave sipërfajësore në toka bujqësore, në disa zona (në varësi të sistemit të kullimit)

Gjatë sezonit dimëror si pasojë e reshjeve të shiut nuk ka patur:

- Dëmtim të infrastrukturës kritike
- Rrëshqitje dherash
- Bllokime të akseve rrugore
- Ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm.

4-SEKTORI I FINANCË MBËSHTETJA

Gjatë vitit 2025, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier ka ushtruar veprimtarinë e tij në zbatim të Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ligjit, nr. 115/2024, “Për Buxhetin e vitit 2025” Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Ligjit Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2024”, VKM Nr. 325 dhe 326 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zevendesministrit, Funkcionareve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” dhe punonjësve mbështetës”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” i korrektuar, Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit vjetor”, Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, Ligjit Nr. 9154 datë 6.11.2003 "Për arkivat" dhe Rregullorja e Brendshme e Institucionit të Prefektit dërguar me urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr.39 datë 20.02.2025, ‘Për Organizimin dhe Funkcionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut, si edhe aneksi 1, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi,

Objektivat e Programit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në funksion të objektivave të institucionit për periudhën janë:

❖ **.Perdorimi dhe menaxhimi me ekonomi efektivitet dhe efijence i fondeve buxhetore nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.**

Realizimi i këtij objekti është arritur nëpërmjet:


- a) Hartimit të planeve të detajuara të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në Ligjin Nr. 10296 Datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndyshuar
- b) Studimit të hollësishëm të nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin 2025, duke bashkëpunuar me sektorët në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangies së shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- c) Kontrolleve në cdo kohë para dhe pas faktit të dokumentacionit sipas ligjeve në fuqi.
- d) Plotësimit të strukturës sipas pozicioneve për secilin sektor.
- e) Bashkëpunimit me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike.
- f) Mirëmbajtjes së aktiveve të Institucionit, duke rritur përgjegjësinë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse brenda limitit të fondeve të planifikuara.
- g) Përmirësimit të kushteve të punës.
- h) Transparencës në dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit, për të gjitha veprimet financiare që kanë lindur në Institucion, hartimin e planeve mujore të punës dhe ndjekjen sistematikisht të realizimit të tyre, përgatitjen e analizave të punës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore sipas *hartës së proceseve kronologjike të punës*.
- i) *Azhornimit kronologjik të veprimeve me thesarin dhe mbylljen e llogarive financiare* sipas ditarëve përkatës dhe në fund të çdo muaji rakordimi me Degën e Thesarit për situacionin e shpenzimeve dhe mbylljen e rezultatit ekonomik-financiar të Institucionit, hartimin e listë pagesave mujore të personelit, të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagën, ndjekjen dhe zbatimin e ligjshmërisë për problemet financiare dhe raportimi në ministrinë e linjës.
- j) Pasqyrimin, rakordimin dhe verifikimin të normës së harxhimit të karburantit cdo muaj.
- k) Shërbimit higjeno-sanitar çdo ditë.
- l) Menaxhimin të burimeve njerëzore në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM Nr.833 datë 28.10.2020 “Për Rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, në zbatim të VKM Nr. 568 datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave mbi kohëzgjatjen e punës edhe të pushimit për punonjësit e administratës shtetërore”
- m) Ndjekjes së vijueshmërisë së punonjësve dhe hartimit të listë pagesave mujore të personelit, të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagën, ndjekja dhe zbatimi i ligjshmërisë për problemet financiare dhe përshtatja me ndryshimin e ligjeve urdhërave e udhëzimeve.
- n) Nëpërmjet bashkëpunimit me DAP.

Plani i buxhetit: Në/ 000 lekë


Buxheti total i planifikuar fillim viti eshte 48 357 mijë lekë, me ndryshime i planifikuar për vitin 2025 është 53 962 mijë lekë

- **-Të ndara sipas programeve:(buxheti fillestar)**
 - Administrata e Prefektit, plani fillestar 44 698 mijë lekë, me ndryshime **48 483** mijë lekë
 - Gjendja civile, si funksion i deleguar plani fillestar 3.659 mijë lekë, me ndryshime **5479** mijë lekë.
- **Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:(P. Fillestar, 48357)**
 - Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 36.366 mijë lekë (75 %) të fondeve e zënë pagat)
 - Kontributi i sigurimeve shoqërore 6056 mijë lekë (13 %)
 - Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 5935 mijë lekë (12 %)
 - Transferta tek individët 0 mijë lekë (0 %)
 - Shpenzime për investime 0 mijë lekë

Në mënyre grafike pesha specifike e zërave të buxhetit ndaj totalit, paraqitet si më poshtë:



PLANI PËRFUNDIMTAR I BUXHETIT ME NDRYSHIME 31.12.2025



Plani me ndryshime **48 483** mijë lekë për Administratën

Plani me ndryshime për Gjendjen Civile **5479** mijë leke

Shuma në vlerë e dy programeve **53962** mije leke


- **Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:**(P.perfundimtar 31.12.2025, 53 962 mije)
 - Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 37891 mijë lekë (70 %) të fondeve e zënë pagat)
 - Kontributi i sigurimeve shoqërore 6351 mijë lekë (12 %)
 - Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 8180 mijë lekë (15 %)
 - Transferta tek individët 540 mijë lekë (1 %)
 - Shpenzime për investime 1.000 mijë lekë (2%)

Realizimi i buxhetit, në 000 lekë per vitin 2025

Programi	Artikulli	Struktura Buxhetore	Buxheti		Realizim i në datë 31. 12.2025	Diferenc a	Realizimi ndaj planit/nd ryshime %
			Plani Fillestar 01.01.202 5	Plani me ndryshime 31.12.2025			
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	33233	33.233	31240	1993	94 %
<i>Prefektura</i>	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5 530	5530	5147	384	93 %
	602	Mallra dhe shërbime të tjera	5935	8180	7851	329	96 %
	606	Trasferta tek Individet	0	540	540	0	100 %
	231	Investime	0	1000	981	19	98 %
		Shuma ne mije /leke Prefekti	44.698	48.483	45.759	2.725	94.4 %
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	3 133	4.658	4652	6	99.9 %
<i>Gj. Civile</i>	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	526	821	777	44	95 %
	602	Mallra dhe shërbime të tjera	0		0	0	0 %
	606	Transferta tek individet	0		0	0	0%
		Shuma ne mije /leke, GJ.Civile	3 659	5479	5429	50	99 %
		BUXHETI TOTAL	48. 357	53.962	51.188	2775	95 %

Realizimi në total për secilin artikull për dy programet (2025)

ARTI KULL I	STRUKTURA BUXHETORE	BUXHETI	REALIZIMI	DIFERENC A	REALIZIMI NË %
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	37.891	35.892	1999	95 %
601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	6.351	5.924	427	93 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	8.180	7.851	329	96 %
606	Transferta tek individët	540	540	0	100 %
231	Investime	1.000	981	19	98 %
	TOTALI	53.962	51.188	2.774	95 %



buxheti eshte realizuar 95 % për të dy programet

- Shpenzimet për paga, shpërblime, shpenzime personeli, janë realizuar 95 %
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 93 %
- Mallra dhe shërbime të tjera, 96 %
- Transferta tek individët, 100 %
- Investim 98 %

- Për vitin 2025 janë realizuar prokurimet për shpenzimet operative si Kancelari, materiale pastrimi, sigurime të mjeteve të transportit, shërbime të ndryshme, taksa të mjeteve të transportit, shlyerja e detyrimeve për të tretët për faturat utilitare, energji, post, internet, shërbimi i rojeve private etj.

Është prokuruar investimi pajisje zyre dhe është realizuar sipas regjistrimit të planifikuar të prokurimeve. *Është siguruar baza materiale e domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të institucionit, si edhe kryerja e shërbimeve të tjera si ai i legalizimit të certifikatave, trajnimit të punonjësve nëpërmjet planifikimit sipas nevojave në bashkëpunim me shkollën shqiptare të administratës publike, nxjerrjes së vërtetimeve për ish-punonjësit e institucionit në vite etj., shërbime ndaj qytetarëve sipas Kërkesave.*

a) Realizimi i të Ardhurave

Institucioni i Prefektit nuk gjeneron të ardhura të mirëfillta për arsye të natyrës institucionale. Të vetmet të ardhura që mund të krijoheshin janë të ardhurat e Gjendjes Civile nga taksat e pullave si funksion i deleguar në Institucionin e Prefektit të Qarkut dhe veprojnë si agjent tatimor ku 95% kalojnë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit dhe vetëm 5% i takojnë institucionit që vepron si agjent tatimor përkatësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Me dixhitalizimin e të dhënave të gjendjes civile për vitin 2025 nuk kemi realizim të ardhurash nga taksa e pullës.

❖ Përmirësim i Kushteve të punës në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.

Realizimi i Buxhetit vjetor për vitin 2025 në masën 95% tregon për punën e mirë të kryer nga Sektori i Financës dhe kolegët, të cilët e kanë mbështetur në realizimin e objektivave të Sektorit për Mirëmenaxhimin e Fondeve Buxhetore, duke rritur Përgjegjësinë Menaxheriale të këtij Sektorit.

Përmirësimi i Kushteve të punës nëpërmjet:

- Kompletimin e zyrave me orëditë e nevojshme pajisje kompjuterike dhe kondicionere.
- Është bërë riformatim i disa njësive kompjuterike.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme për zyrat. po kështu është kryer higjienizimi çdo ditë i ambjentëve të institucionit, është kryer dhe kontrolluar dhe **monitoruar në mynyrë të rregullt shërbimi i rojeve private për godinën.**
- Është punuar për Standardizimin dhe sistemimin e dokumentacionit në arkivë dhe vazhdimisht është ushtruar kujdesi për mirëmbajtjen e ambienteve të punës.
- Është punuar për Mirëmbajtjen e aktiveve të Institucionit, nëpër rritjes së përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për secilin punonjës të institucionit.

❖ Raportimi, saktësimi dhe përditsimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.

Ka qënë prioritet i punës bazuar në VKM Nr, 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023 për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.

-Është marë Cerifikate e pronësisë e përditësuar dhe e regjistruar si një ndër pronat qeveritare me përparësi, për godinën Fier në inventar të institucionit. Është përditësuar edhe godina Lushnje por me hartë kadastrale jo përfundimtare për arsye të mos azhornimit të gjithë pronave të zonës kadastrale të ASHK Lushnje, është azhornuar statusi juridik i pronës me statusin e përdoruesit faktik të pronave të paluajtshme shtetërore për marjen e certifikatës së pronësisë pasi ishin vetëm me vërtetime hipotekore.

- ❖ **Plotësimi i vendeve vakante dhe menaxhimi i burimeve njerëzore sipas aftësive profesionale, përshkrimeve sipas pozicionit dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë .**

Ky objektiv është në proces për shkak të vakancave të krijuara rishtas:

- a) Duke zbatuar procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me legjislacionin për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprore sipas shkallës së hierarkisë, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), duke iu referuar strukturës plan dhe fakt, shpalljes së vendeve vakante sipas kriterëve, përshkrimeve dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në fuqi.
- b) *Nepermjet Administrimit të sistemit HRMIS, hedhjes së të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online,*
- c) Në zbatim të ligjit të nëpunësit civil 152/2013, VKM Nr. 833 Datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, regjistrin qendror të personelit”, VKM Nr. 568 Datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave mbi kohëzgjatjen e punës edhe të pushimit për punonjësit e administratës shtetërore”,
- d) Rishikimit të dosjeve të personelit duke i azhornuar me regjistrin qendror të personelit dhe sistemin HRMIS,
- e) Ngritjen e nivelit profesional të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme dhe trajnimeve të tjera nga programe të ndryshme të organizuar nga ASPA.

Për sa i përket personelit mbi nëpunësit civil për vitin 2025 janë krijuar 4 vende vakant :

Konkretisht po analizojme menaxhimin e proceseve të shërbimit civil gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025.

❖ Të dhëna në lidhje me strukturën dhe organikën në fuqi.

Struktura dhe organika në fuqi, në bazë të së cilës është organizuar dhe funksionon institucioni i Prefektit të Qarkut Fier është miratuar me Urdhërin nr.106, datë 09.07.2024, të Kryeministrit, “Për një ndryshim në urdhërin nr.4, datë 12.01.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Administratës së Prefektit të Qarkut të Fierit.

Struktura dhe organika në fuqi e institucionit të Prefektit të Qarkut Fier , ka parashikuar 29 pozicione pune gjithsej, ku:

23 pozicione pune, rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.


3 pozicione pune, janë të zgjedhur dhe funksionarë kabineti.

3 pozicione pune, janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje etj) dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

❖ Të dhëna në lidhje me ndarjen e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive të shërbimit civil.

- 1 pozicion i shërbimit civil, futet në kategorinë e mesme drejtuese Sek/Përgjithshëm (drejtor drejtorie, pozicione të barasvlershme me të).
- 5 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (përgjegjës sektori, pozicione të barasvlershme me të).
- 17 pozicione të shërbimit civil, janë pozicione të kategorisë ekzekutive (specialistë).

Paraqitja grafike si me poshte:



❖ *Të dhëna në lidhje me mënyrën e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil.*

MËNYRA E PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË SHËRBIMIT CIVIL				
Institucioni	Numri i pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës	Numri i pozicioneve në shërbimin civil të plotësuar sipas ligjit	Numri i pozicioneve të plotësuar me punonjës të emëruar me kontratë pune / akt emërimi të titullarit <u>pa u zbatuar procedurat e konkurrimit /në kundërshtim me ligjin (nëse ka)</u>	Numri i pozicioneve të lira në shërbimin civil
Prefekt i Qarkut Fier	23	19	0	4

❖ *Të dhëna në lidhje me rekrutimin për periudhën Janar - Dhjetor 2025.*

2 pozicione të shërbimit civil, gjithsej të plotësuar në zbatim të procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutive

- Emërimet me procedurën e Lëvizjes paralele __0__ punonjës.
- Emërimet me procedurën Pranim në kategorinë *ekzekutive* të shërbimit civil __1__ punonjës.

1.Valbona Azizi, Specialiste, Sektori e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, klasa e pagës IV-3, Nr: 5126 prot, datë 13.10.2025.

❖ **Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues:**

- Emërimet me procedurën e Lëvizjes paralele __0__ punonjës.
- Emërimet me procedurën e Ngritjes në detyrë __1__ punonjës, (____ ngritje në detyrë me nëpunës civilë, __0__ ngritje në detyrë me kandidatë nga jashtë shërbimit civil).

1. **Ledion Gjoka**, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, klasa e pagës III-2, Nr: 962 prot “Emërim” datë 05.02.2025, (ngritje në detyrë).
- Pozicione të plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi/ në kundërshtim me ligjin nuk kemi.

❖ **Në lidhje me numrin e nëpunësve civilë të konfirmuar.**

2 (Dy) nëpunës janë konfirmuar me statusin “Nëpunës civil”, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025.

· **Irisa Miho**, Specialiste në Sektorin e Zhvillimit Urban, Akt i deklarimit të statusit nr:716/1 prot, datë 03.02.2025,(pas marrjes se statusit eshte larguar)

· **Albion Arizi**, Specialist Sektori Juridik, Akt i deklarimit të statusit nr:1847/1 prot, datë 20.03.2025.aktualisht specialist ne Sektorin Juridik.

Nuk ka pasur masa disiplinore të aplikuara ndaj nëpunësve civilë.

- ❖ Në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për periudhën Janar - Dhjetor 2025 kemi pasur 2 nenpunës civil me doreheqje.

Arsyeja e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil		Numri i rasteve në institucionet e administratës shtetërore
a. Lirimi nga shërbimi civil, për shkak të:	Refuzimit të pozicionit të ofruar nga ristrukturimi	0
	Mbylljes ose ristrukturimit	0
	Paaftësi për punë, vlerësuar nga komisioni mjekësor	0
	Dy vlerësimeve jo kënaqshëm	0
	Konfliktit të vazhdueshëm të interesit	0
	Dorëheqjes	2
	Për arsye të tjera (<i>specifiko</i>)	0
b. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, për arsye:	Daljes në pension	0
	Pavlefshmërisë absolute e aktit të emërimit	0
	Për arsye të tjera (<i>specifiko</i>)	0
c. Largimi nga shërbimi civil, si masë disiplinore	Për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore	0
Totali		2

1. Iriša Miho, Specialiste e Sektorit të Zhvillimit Urban, akt nr.161/2 prot, datë:31.01.2025.
2. Blerta Gjoka, Specialiste e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, akt nr. 1157/1 prot, datë 20.10.2025.

- ❖ Asnjë nëpunës nuk ka pezulluar marrëdhëniet në shërbimin civil për periudhën janar 2025 - dhjetor 2025

- ❖ Në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë (Janar - Qershor 2025).

Institucioni	Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel				Totali
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm	
	(1)	(2)	(3)	(4)	
	15	5	0	0	

- ❖ Të dhëna në lidhje me arsimin e nëpunësve civilë.

Të punësuar gjithsej	Arsimuar në institucione publike arsimore	Arsimuar në institucione private arsimore	Arsimuar në institucione jashtë vendit
20	18	2	0

- ❖ Të dhëna në lidhje me ndarjen e të punësuarve sipas gjinisë.

Të punësuar gjithsej	Gra	Burra
20	10	10

Institucioni **nuk ka** vendime gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në vendin e mëparshëm të punës të paekzekutuar.

Ndjekja e detyrave të urdhërit për Autoritet Përgjegjës dhe komunikimi me ILDKPI.

-Funksionimi i rregullt i programit EACIDS për plotësimin online të deklaratave të pasurisë për funksionarët politike për ILDKPI dhe është dërguar raporti vjetor në ILDKPI.

në 5 sektorë dhe që ka një organikë prej 29 punonjësish. Si funksion i deleguar është vetëm Arkiva e Gjendjes Civile në Fier dhe dy Nënprefekturat me 3 punonjës gjithsej(32 punonjë)

Prioritet i punës për vitin 2025 ka qenë azhurnimi i dosjeve të personelit në regjistrin elektronik të punonjësve (HRMIS).

Mbetet objektiv edhe detyrë për shtimin në organikë të një punonjësi IT në Institucion për arsye të domosdoshme të shërbimeve kompjuterike dhe mbarëvajtjen e sistemeve online që përdoren në institucion, bazuar në shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.7341/1Prot datë 12.07.2023, “Për njohje dhe zbatim të shkresës me nr.3537prot datë 06.07.2023 të Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së informacionit, në bashkëpunim dhe miratim të ministrisë së linjës dhe plotësimit të vakancës.

❖ **Standartizimi dhe përmirësimi i punës mbi arkivimin e dokumentacionit.**

- a. Është bërë standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier.
- b. Është punuar për Standardizimn e mënyrës së hartimit të urdhërit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, kthim përgjigjeve dhe arkivimit pas përfundimit të praktikave të ndryshme për përmirësimin e punës në institucion.
- c. Është kërkuar dhe punuar nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse(Arkiva) mbi konceptimin e shkresave duke zbatuar me rigorozitet gjuhën shqipe dhe përmirësimin e mënyrës së formulimit të dokumentit sipas strukturës.
- d. Është shoqëruar çdo shkresë me kartelën shoqëruese.
- e. Është hartuar pasqyra emertuese e çeljes së dosjeve për dokumentet me afat ruajtje RHK dhe jo RHK.
- f. Kryerja çdo ditë e Regjistrimit të korrespondencës, arkivimit të praktikave të ndryshme, shkresave zyrtare që prodhon institucioni, evidentimi, përpunimi, shpërndarja dhe protokollimi i shkresave që hyjnë dhe dalin nga Institucioni, si dhe shkresave që lëvizin brenda Institucionit.
- g. Dorëzimi ne AQV bëhet sipas kalendarit të miratuar nga DPA,
- h. Mbetet detyrë dhe objektiv dorëzimi i dokumentacionit të përpunuar në AQV sipas radhës në vite.

5-Objektivat e Sektorit të Zhvillimit Urban për Vitin 2026

- Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban.
- Të japë konsulencë dhe koordinojë punën me njësitë e vetqeverisjes vendore, Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore në qark, për çështje dhe problematika që hasin në procesin e planifikimit të territorit.
- Të kontribuojë në nxitjen e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimaterike dhe një zhvillimi të qëndrueshëm.
- Të kontribuojë në nxitjen e programeve për një shëndet urban më të mirë.

Objektivat janë realizuar si më poshtë :

- ***Ndjekja e zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për gjashtë bashkitë e qarkut : Fier, Lushnje, Mallakastër, Divjakë,Patos, Roskovec.***

Asnië PDV nër 2025

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK)	PPV Fier	
	PPV Lushnje	Asnjë PDV për 2025
	PPV Mallakastër	Asnjë PDV për 2025
	PPV Divjakë	Asnjë PDV për 2025
	PPV Patos	Asnjë PDV për 2025
	PPV Roskovec	Asnjë PDV për 2025

QARKU FIER




Plani i
Përgjiths
hëm
Kombëtar

Planet e
Përgjiths
hme

Rishiki
me
(5)

➤ Kontrollit të Zhvillimeve në Territor

Është kryer procesi i kontrollit të zhvillimeve në territor me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për vitin 2024. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014“Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorrit” ky raportim mbyllet deri më 25 Mars të vitit pasardhës dhe është raportuar botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorrit, nga ana e Njësive të Vetqeverisjes Vendore!



Institucioni	Leje infrastrukture	Deklarata paraprake	Leje ndërtimi	Leje Zhvillimi	Leje për shtyrje afati	Njoftim për fillim punimesh	Leje për ndryshim projektsh	Çertifikatë përdorimi
Bashkia Fier	2	61	28	20	3	5	5	7
Bashkia Lushnje	9	48	60	42	1	7	5	17
Bashkia Mallakastër	3	13	3	5	1	3	1	1
Bashkia Divjakë	1	12	19	0	0	0	3	0
Bashkia Patos	7	8	4	1	0	0	1	0
Bashkia Roskovec	64	13	4	3	0	12	1	3
TOTAL	86	155	118	71	5	27	16	28

➤ **Aktiviteti i Dites së Tokës 22 Prill 2025 !**

U miratua programi i Ditës së Tokës me temë

“Our Power, Our Planet ” me Nr.Prot 463 Datë 15.04.2025 :

- Qyteti pa makina në fashën orare 8.00-12.00 për Qarkun Fier

Programi u ndoq dhe u zbatua në Rang Qarku

- Aktivitete lokale nën moton ndërkombëtare
- *Aksion pastrimi nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore*

Programi u ndoq dhe u zbatua në Rang Qarku

➤ **Ndjekja e Aksionit të Pastrimit për gjithë Qarkun Fier !**

Në kuadër të nismës së Kryeministrit “ SHQIPËRIA E PASTËR”, me Urdhër të Prefektit Nr.49 datë 25.11.2021 është ngritur grupi i punës ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin dhe higjienizimin e mjedisit nga mbetjet në Qarkun Fier! Për vitin 2025 Sektori i Zhvillimit Urban vijon koordinimin e aksionit të pastrimit , shoqëruar me planifikime javore dhe raportime mujore .

Planifikimet Javore përmbledhen në rang qarku dhe dërgohen në grupin ehatsapp në Planin Kombëtar të Pastrimit.

Janë kryer **48 monitorime në terren** mbi zbatimin e Planit Javor të Pastrimit .


Pas monitorimeve raportet ju dergohen bashkive kur hasen problematika!

Raporti Mujor përmbledhës dërgohet në Ministrinë e Mjedisit!


Problematikë mbetet kultura e përgjithshme mbi mbajtjen pastër të mjedisit sidomos në zonat rurale, ku vihet re që ndotja me e madhe është në zonën afër koshave të mbeturinave : koshat bosh, territori rreth koshave i ndotur !

➤ **Buxheti i Pastrimit 2025**

Njësia Vetqeverisjes Vendore	Buxheti i Pastrimit 2021	Buxheti i Pastrimit 2022	Buxheti i Pastrimit 2023	Buxheti i Pastrimit 2024	Buxheti i Pastrimit 2025	Buxheti i Pastrimit 2026
Bashkia Fier	185.836.000	186.307.812	235.855.353	272.318.972	186.286.000	361.123.547
Bashkia Lushnje	83.454.000	109.887.000	111.649.522	115.876.745	99.193.156	44.800.000
Bashkia Mallakastër	12.786.675	43.374.143	48.621.551	50.420.551	48.584.236	58.909.000
Bashkia Divjakë	25.292.820	40.093.484	112.691.790	115.521.105	42.205.769	39.999.154
Bashkia Patos	34.193.648	35.593.648	41.167.487	53.388.366	55.737.667	63.323.000
Bashkia Roskovec	31.617.434	37.493.422	45.330.221	50.999.686	57.769.670	43.106.352




Njësia Vetqeverisjes Vendore	TOTAL BUXHET 2026	Buxheti i Pastrimit 2026	%NDAJ TOTAL BUXHET
Bashkia Fier	3.021.214.095	361.123.547	11.95 %
Bashkia Lushnje	2.132.797.335	44.800.000	2.1 %
B. Mallakastër	1.019.531.088	58.909.000	5.70 %
Bashkia Divjakë	1.078.088.893	39.999.154	3.70 %
Bashkia Patos	733.839.281	63.323.000	8.60 %
Bashkia Roskovec	714.537.355	43.106.352	6.03 %



➤ **Depozitimi i mbetjeve urbane**

Bashkia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	SasiaTot (ton)
Fier	2253.6	1803.9	2076.8	1920	2037	2120	2448	2536	2293.7	2361	2165.7	2368.5	26387
Lushnje	1253	1049	1171	1164	1125	1175	1379	1535	1250.2	1304	1267.1	1357	15031.7
Mallakastër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Divjakë	536.	469.0	523.6	470	459	507	563	659.8	510.3	461.4	495.4	534	6175
Patos	321.9	237.1	277.7	295.3	297.1	270.7	268.2	419	313.1	291.4	290.5	319	3601.1
Roskovec	223	216.3	238.3	228.9	233.6	227.9	268.2	315.1	243.1	235.2	251.1	81.3	2991.7



v.o : Bashkia Mallakaster nuk depoziton mbetjet ne Impiantin e Përpunimit te Mbetjeve Fier

➤ **Ndjekja e Mbledhjeve të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur : Parku Kombetar Divjakë Karavasta**

Është mbajtur **1** (një) Mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta:

- *Datë 30.09.2025 në ambientet e Prefektit të Qarkut Fier.*

U prezantuan projektet dhe risi për Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

Problematika :

- *dezinfektimi për të cilin është mbajtur kontakt me Ministrinë dhe Agjencinë e Shëndetit Publik për ta realizuar në kohën e duhur!*
- *Problem i komunikimit me detin*
- **v.o :** Mbledhja e dytë nuk u zhvillua nga ana e Administratës së Zonave të Mbrojtura edhe pas kërkesës së Institucionit të Prefektit!

Zonat e Mbrojturta Fier	Viti	Vizitorë Vendas	Vizitorë të Huaj
PKDK	2023	495170	136040
	2024	313695	105700
	2025	357320	134980
Pish Poro	2023	209200	4530
	2024	155400	16380
	2025	170080	19410
Vjosa	2023	500	600
	2024	23000	22260
	2025	14660	19600

➤ Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në rang Qarku !

BASHKIA	SIPËRFAQE TË GJELBRA TË SHTUARA (m²)
FIER	Nuk ka raportuar
LUSHNJE	5947
MALLAKASTËR	0
DIVJAKË	0
PATOS	3540
ROSKOVEC	0

Sipërfaqe të gjelbra të shtuara
(m²)



❖ TË TJERA

Veprimtaria “Për luftën kundër Kanabisit”

- Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka vijuar ndjekja e veprimtarive të punës nga strukturat vendore si me bashkitë dhe Degët Territoriale dhe në mënyrë të veçantë me strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, ku për vitin 2025, në bazë të të dhënave të administruara nga Komunikata e Policisë, është përditësuar baza e të dhënave për rastet e kultivimit të kanabisit, ku janë evidentuar 11 raste të kultivimit:
- Pesë raste në territorin e Bashkisë Fier, ku janë gjetur dhe asgjësuar 2207 bimë të dyshuara kanabis sativa. Për këto raste janë ndaluar/arrestuar 11 shtetas.
- Katër raste në territorin e Bashkisë Mallakastër, ku janë gjetur dhe asgjësuar 1947 bimë të dyshuara si kanabis sativa. Për këto raste janë arrestuar 4 shtetas.
- Dy raste në territorin e Bashkisë Roskovec, ku janë gjetur dhe asgjësuar 201 bimë të dyshura kanabis sativa. Për këto raste janë nadalua/arrestuar 3 persona.

Në kuadër të luftës kundër kultivimit të kanabisit gjatë muajit Shkurt, në Institucionin e Prefektit është zhvilluar një takim sensibilizues me pjesëmarrës të Drejtuesve të strukturave vendore. Gjithashtu, Institucioni i Prefektit ka marrë pjesë edhe në takimet sensibilizuese të organizuara nga Komisariati i Policisë Fier, në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier.

❖ **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026 PËR INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT FIER JANË :**

- ❖ **Rritja dhe konsolidimi i frymës institucionale gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ me organet e vetëqeverisjes vendore duke synuar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes të njësive të vetëqeverisjes vendore si dhe rritjen e standartit të procesit të verifikimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.**

Veprimet për zbatimin e objektivit:

- Verifikimi ligjor i akteve me karakter normativ nga ana e sektorit juridik. Kryerja e verifikimit në vend të akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi përsa i përket verifikimit ligjor të akteve.
 - Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me sekretarët e këshillave bashkiak.
- ❖ **Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.**

- Përfaqësim me autorizim i Prefektit të Qarkut në proceset gjyqësore në të cilat është palë. Hartimi i të gjitha kërkesave procedurale për mbrojtjen e interesave legjitim të institucionit të Prefektit.

❖ **Rritja e standartit ligjor të hartimit të shkresave nga administrata**

Veprimet për realizimin e këtij objekti

- Zbatimi i Programit të Qeverisë 2025 -2029
- Monitorimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për të gjashtë njësitë e vetqeverisjes vendore të Qarkut Fier!

❖ **Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimi i detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban.**

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Të japë konsulencë dhe koordinojë punën me njësitë e vetqeverisjes vendore, Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore në qark, për çështje dhe problematika që hasin në procesin e planifikimit të territori
- Të kontribuojë në nxitjen e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet kimaterike dhe një zhvillim të qëndrueshëm.
- Të kontribuojë në nxitjen e programeve për një shëndet urban më të mirë.

❖ **Menaxhimi financiar, kontrolli i brendshëm, Menaxhimi i rriskut dhe i kontrollit, monitorimi dhe zbatimi i buxhetit të Institucionit**

Veprimet për realizimin e këtij objekti

- Hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Studimi i hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde për vitin 2025, duke bashkëpunuar me sektorët, në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- Bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike.
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

❖ **Permiresim i kushteve të punës në mbështetje të personelit, si në aspektin jetësor dhe në atë funksional.**

Veprimet për realizimin e këtij objekti

- Përmirësimi i kushteve të punës, në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.
- Kompletimi i zyrave me orëditë e nevojshme.
- Pajisja me bazë materiale të përditshme.
- Standardizimi i sistemit të dokumentacionit në zyrë dhe kujdesit për ambientin e punës.

- Zbatimi i kodit të etikës në punë j,
- Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

❖ **Standartizimi, sistemimi dhe Arkivimi i dokumentave**

Veprimet për realizimin e këtij objekti:

- Standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
- Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave ankesave, kthim përgjigjeve etj
- Zbatimi me rigorozitet i gjuhës shqipe dhe përmirësimit të mënyrës së formulimit të dokumentit.
- Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentacionit arkivor në vite.
- Përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit.

❖ **Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerezore**

Veprimet për realizimin e këtij projekti:

- Njohja dhe zbatimi i legjislacionit për nëpunësin civil, emërimin, lirim, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprorëve sipas shkallës së hierarkisë,
- (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Brendshme.
- *Administrimi i HRMIS*, hedhja e të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online.

❖ **Monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit urban.**

Veprimet për realizimin e këtij objekti

- Zbatimi i Programit të Qeverisë 2025-2029
- Monitorimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për të gjashtë Njësitë e vetqeverisjes vendore të Qarkut Fier!

❖ **Dhënie konsulencë dhe koordinim I punës me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe institucionet e tjera shtetërore në qark, për çështje dhe problematika që hasin në procesin e planifikimit të territorit!**

Veprimet për realizimin e objektit:

- Përmirësimi i procesit të planifikimit për territorin e qarkut.

- Komunikimi periodik me njesite e Vetqeversjes vendore ose përgjigje ndaj kërkesave të tyre sipas mënyres së përcaktuar me ligj.
- Koordinimi i punës dhe respektimin e hierarkisë institucionale me synimin e zhvillimit të territorit sipas mënyres së përcaktuar me ligj.

❖ **Nxitja e programeve në drejtim të përshtatjes me ndryshimet klimaterike dhe një zhvillim të qëndrueshëm**

Veprimet për realizimin e objektivit

- Nxitja e një zhvillimi të qëndrueshëm që do të rezistojë ndryshimeve klimaterike dhe një zhvillimi afatgjatë.
- Ndjekja e trainimeve dhe direktiva të qeverisë për tju ardhur në ndihmë njesive të vetqeverisjes vendore
- Ndjekja e direktivave të programit të qeverisë dhe botimet e Agjencisë së Mjedisit

❖ **Sigurimi i funksionimit të sistemit të pralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku**

Veprimet për realizimin e objektivit

- Sigurimi i informacionit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, duke iu mundësuar institucioneve dhe komunitetit të rrezikuar, marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e pasojave që mund të ndodhin gjatë emergjencave të mundshme.

❖ **Rritja e rolit të Institucionit të Prefektit në fushën e Mbrojtjes Civile (MC)**

Veprimet për realizimin e objektivit

- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë së organeve, institucioneve dhe strukturave të MC që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile apo edhe anazhimit të strukturave qendrore në situatat emergjente që dalin përtej mundësisë menaxhuese nga ana e strukturave vendore

❖ **Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile**

Veprimet për realizimin e objektivit

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në raport me mbrojtjen civile si dhe rritjen profesionale brenda fushës së përgjegjësisë për nëpunësit e Sektorit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile.

